



Albanian-American  
Development Foundation



PIRAMIDA

**CONTRACT  
FOR CONSTRUCTION SERVICES**

Between

**Albanian-American Development  
Foundation**

And

**Piramida Center**

And

**[Company name]**

For  
[insert]

Contract no: \_\_\_\_\_-237  
Date: \_\_\_\_\_, 2026

**KONTRATË  
SIPËRMARRJEJE**

ndërmjet

**Albanian-American Development  
Foundation**

dhe

**Qendra Piramida**

dhe

**[emri i kompanisë]**

Për  
[shëno]

Nr. i kontratës: \_\_\_\_\_-237  
Datë: \_\_\_\_\_, 2026

This Contract is entered into between:

**ALBANIAN-AMERICAN DEVELOPMENT FOUNDATION**, a non-for-profit organization duly organized and established under the laws of the state of Delaware, with registered seat at 780 Third Ave, Floor 46, New York, NY 10017, U.S.A. acting through its Albanian branch registered with Tirana District Court decision no. 359 dated 18.03.2011, with tax number L11618452N and registered address at Rr. Ibrahim Rugova, building no. 42, entrance 7, apartment 60, 1019 Tirana, Albania, duly represented by Mr. Martin Mata and Mr. Aleksandër Sarapuli (“**AADF**” or the “**Employer**”)

and

**Piramida Center**, a non-for-profit organization, duly established under the laws of Albania, registered with the Non-Profit Organizations register by virtue of decision no. 1520, dated 17.09.2020 of the Tirana Court of First Instance of General Jurisdiction, with tax identification number M02201453B and legal seat at the address: Pyramid of Tirana, Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Tirana, Albania, duly represented by its Executive Director, Ms. Shqipe Berisha (the “**Beneficiary**”)

and

**[contractor’s name]**, a *[insert type of company]* company, duly organized and established under the laws of Albania, registered with the National Business Centre with unique identification number *[insert NIPT]*, with legal seat at the address: *[insert legal seat]*, duly represented by *[insert legal representative]*, (the “**Contractor**”).

Collectively, the AADF, the Beneficiary and the Contractor are referred to as “**Parties**” and individually as “**Party**”

#### RECITALS:

(A) The AADF led the revitalization and transformation of the Pyramid of Tirana into a leading center for youth, technology, education, and innovation. As part of its ongoing commitment to this project, AADF intends to support Beneficiary in enhancing and safeguarding the long-term functionality of the building, even with rising footfall demands. This will be ensured by upgrading the existing infrastructure, specifically the access control

Kjo Kontratë lidhet ndërmjet:

**ALBANIAN-AMERICAN DEVELOPMENT FOUNDATION**, një organizatë jofitimprurëse e organizuar dhe e themeluar sipas ligjeve të shtetit të Delaware-it, me seli të regjistruar në 780 Third Ave, Floor 46, New York, NY 10017, U.S.A., e cila vepron nëpërmjet degës së saj në Shqipëri, e regjistruar me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 359 datë 18.03.2011, me NIPT L11618452N dhe e regjistruar në adresën Rr. “Ibrahim Rugova”, pallati nr. 42, hyrja 7, apartamenti 60, 1019 Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga z. Martin Mata dhe z. Aleksandër Sarapuli (“**AADF**” ose “**Punëdhënësi**”)

dhe

**Qendra Piramida**, një organizatë jofitimprurëse, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, regjistruar pranë regjistrimit të Organizatave Jofitimprurëse me vendim nr. 1520, datë 17.09.2020 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me NIPT M02201453B dhe seli në adresën Piramida e Tiranës, Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv, Znj. Shqipe Berisha (“**Përfituesi**”)

dhe

**[emri i kontraktorit]**, një shoqëri *[shëno llojin e shoqërisë]*, e organizuar dhe e themeluar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NIPT *[shëno NIPT-in]*, me seli ligjore në adresën: *[shëno selinë ligjore]*, e përfaqësuar nga *[shëno përfaqësuesin ligjor]*, (“**Kontraktori**”).

AADF, Përfituesi dhe Kontraktori referohen bashkërisht si “**Palët**” dhe individualisht si “**Pala**”.

#### PREAMBULA:

(A) AADF udhëhoqi rivitalizimin dhe transformimin e Piramidës së Tiranës në një qendër kryesore për rininë, teknologjinë, arsimin dhe inovacionin. Si pjesë e angazhimit të tij të vazhdueshëm në këtë projekt, AADF synon të mbështesë Përfituesin në përmirësimin dhe ruajtjen e funksionalitetit afatgjatë të ndërtesës, madje edhe përballë kërkesave në rritje nga fluksi i vizitorëve. Kjo do të garantohet përmes përmirësimit të infrastrukturës ekzistuese, veçanërisht të sistemit të kontrollit të

system, lighting system, and flooring surfaces.

- (B) The Contractor was selected for the implementation of the Works, agreed to be financed with AADF funds.

**NOW THEREFORE** the Parties hereto hereby agree as follows:

## **1 DEFINITIONS**

**1.1** The capitalized terms used in this Contract shall have the meanings set out herein below:

- (a) "Aesthetical Supervisor" means the architects who have prepared the Detailed Design and are appointed by AADF for the aesthetical supervision of the implementation of the Works, in the meaning of Law 8402/1998 "On control and regulation of construction works" as amended.
- (b) "Beneficiary" means the Piramida Center to which the AADF will donate the investment funded by the AADF for the implementation of the Project.
- (c) "Commencement date" means the date notified in writing by AADF to the Contractor for the commencement of the Works under this Contract pursuant to Clause 3.2.
- (d) "Completion Date" means the date of completion of the Works as per this Contract pursuant to the Schedule of Works agreed between the Parties.
- (e) "Confidential Information" means any information, technical data, or know-how (including, but not limited to, information relating to research, products, software, services, development, inventions, processes, engineering, marketing, techniques, internal procedures, business and marketing plans or strategies, finances, employees and business opportunities) disclosed by the disclosing party to the other party either directly or indirectly in any form whatsoever (including, but not limited to, in writing, in machine readable or other tangible form, orally or visually): (a) that has been marked by the disclosing party as "confidential"; (b) whose confidential nature has been made known by disclosing party to the other party, in writing or orally (with specific written notification of such oral disclosure within three (3) days thereafter);

aksesit, sistemit të ndriçimit dhe sipërfaqes së dyshemesë.

- (B) Kontraktori u përzgjedh për zbatimin e Punimeve, të dakordësuara për t'u financuar me fondet e AADF.

**PËR SA MË SIPËR**, Palët bien dakord si vijon:

## **1. PËRKUFIZIMET**

**1.1** Termat me shkronjë të madhe të përdorura në këtë Kontratë kanë kuptimet e mëposhtme:

- (a) "Mbikëqyrësi Estetik" nënkupton arkitektët që kanë përgatitur Projektin e Detajuar dhe janë caktuar nga AADF për mbikëqyrjen estetike të zbatimit të Punimeve, siç parashikohet nga Ligji 8402/1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar.
- (b) "Përfituesi" nënkupton Qendrën Piramida, të cilës AADF do t'i dhurojë investimin e financuar nga AADF për zbatimin e Projektit.
- (c) "Data e Fillimit" nënkupton datën e njoftuar Kontraktorit me shkrim nga AADF për fillimin e Punimeve sipas kësaj Kontrate në përputhje me Nenin 3.2.
- (d) "Data e Përfundimit" nënkupton datën e përfundimit të Punimeve sipas kësaj Kontrate, në përputhje me Grafikun e Punimeve të dakordësuara ndërmjet Palëve.
- (e) "Informacioni Konfidencial" nënkupton të gjitha informacionet, të dhënat teknike ose njohuritë (duke përfshirë, por pa u kufizuar, informacion në lidhje me kërkimin, produktet, softuerin, shërbimet, zhvillimin, patentat për shpikjet, proceset, inxhinierinë, marketingun, teknikat, procedurat e brendshme, planet ose strategjitë e biznesit dhe marketingut, financat, punonjësit dhe mundësitë e biznesit) që bëhen të njohura nga pala zbuluese te pala tjetër drejtpërdrejt ose tërthorazi në çfarëdo forme (duke përfshirë, por pa u kufizuar në, format me shkrim, me interpretim të automatizuar, me përpunim kompjuterik ose çdo formë tjetër materiale, verbalisht ose vizualisht): (a) të cilat janë kategorizuar nga pala zbuluese si "konfidenciale"; (b) natyra konfidenciale e të cilave është bërë e ditur nga pala zbuluese te pala tjetër, me shkrim ose me gojë (me njoftim specifik me shkrim për një zbulim të

or (c) that due to its character, nature, or method of transmittal, a reasonable person under like circumstances would treat as confidential.

"Confidential Information" shall not include, however, information that is:

- (a) in the public domain at the time of disclosure, or is subsequently made available to the general public without restriction by the disclosing party;
  - (b) known to the receiving party at the time of disclosure without restrictions on its use or independently developed by the receiving party, i.e without access to the information disclosed by the disclosing party, and there is adequate documentation to demonstrate either condition;
  - (c) used or disclosed with the prior written approval of the disclosing party; or
  - (d) disclosed without restriction to the receiving party from a source other than the disclosing party.
- (f) "Contract" means the present contractual provisions, the technical specifications, the project-related documentation, drawings, specifications, technical requirements, bill of quantities, Contractor technical proposal, tender terms and conditions and all annexes therein (if any).
- (g) "Detailed Design" means the drawings and technical specifications of the Works, as included in Annex II of the Contract, and any additional and modified drawings issued in accordance with the Contract, and approved by the responsible authorities.
- (h) "Final Acceptance Certificate" means the document issued by Employer and signed by the Supervisor and the Contractor after expiry of the Warranty Period, by means of which are accepted by Employer all of the Works subject of this Contract.
- (i) "Materials" means all materials (other than Plant), whether on the Site or otherwise allocated to the Contract and intended to form or forming part of the Works.
- (j) "Plant" means the apparatus, equipment, machinery and vehicles (including any components) whether on the Site or otherwise allocated to the Contract and intended to form or

tillë informacioni me gojë brenda tre (3) ditëve pas këtij zbulimi); ose (c) të cilat, për shkak të karakterit, natyrës ose mënyrës së transmetimit, një person i arsyeshëm në rrethana të caktuara do t'i trajtonte si konfidenciale.

Megjithatë, "Informacioni Konfidencial" nuk do të përfshijë ato informacione:

- a) që janë të aksesueshme publikisht në kohën e zbulimit të tyre ose që janë vënë në dispozicion të publikut të gjerë pa kufizime nga pala zbuluese;
  - b) që janë të ditura për palën marrëse në kohën e zbulimit pa kufizime në lidhje me përdorimin e tyre ose që janë krijuar apo zhvilluar nga pala marrëse në mënyrë të pavarur, d.m.th. pa akses në informacionin e dhënë nga pala zbuluese, dhe ekziston dokumentacion i mjaftueshëm për të demonstruar secilën rrethanë;
  - c) që janë përdorur ose zbuluar me miratimin paraprak me shkrim të palës zbuluese; ose
  - d) që i janë zbuluar pa kufizime palës marrëse nga një burim tjetër dhe jo nga pala zbuluese.
- (f) "Kontrata" nënkupton këto dispozita kontraktuale, specifikimet teknike, dokumentacionin që lidhet me projektin, vizatimet, specifikimet dhe kërkesat teknike, preventivi, propozimi teknik i Kontraktorit, kushtet dhe afatet e tenderit dhe të gjitha anekset (nëse ka).
- (g) "Projekti i Detajuar" nënkupton vizatimet dhe specifikimet teknike të Punimeve, ashtu siç janë dhënë në Aneksin II të Kontratës, si dhe çdo vizatim shtesë dhe i modifikuar që është lëshuar në përputhje me Kontratën, dhe miratuar nga autoritetet përgjegjës.
- (h) "Certifikata Përfundimtare e Marrjes në Dorëzim" nënkupton dokumentin e lëshuar nga Punëdhënësi dhe i nënshkruar nga Mbikëqyrësi dhe Kontraktori pas mbarimit të Periudhës së Garancisë, me anë të të cilit Punëdhënësi ka pranuar të gjitha Punimet që janë objekt i kësaj Kontrate.
- (i) "Materialet" nënkupton të gjitha materialet (përveç Pajisjeve) që ndodhen në Kantier ose në zona të tjera siç specifikohet në Kontratë, dhe të cilat synohet të jenë ose do të jenë pjesë e Punimeve.
- (j) "Pajisjet" nënkupton aparaturat, pajisjet, makineritë dhe automjetet (duke përfshirë çdo komponent) që ndodhen në Kantier ose në zona të tjera siç specifikohet në Kontratë, dhe të cilat synohet të jenë

forming part of the Works.

- (k) "Project" means the project, funded by AADF in accordance with the proposal and budget approved by its own Board of Trustees.
- (l) "Provisional Acceptance Certificate" means the document issued by the Employer to the Contractor and signed by the Supervisor and the Contractor after completion of the Works and issue of the commissioning act, establishing conditional acceptance by Employer of the Works performed under this Contract, subject to the Warranty Period.
- (m) "Schedule of Works" means the schedule of works agreed between the Parties, in which the terms for the performance of the separated stages of the Works have been determined, part of the Contractor's Technical Proposal attached as Annex III, being an integral part of the Contract.
- (n) "Site" means the place where the Works are to be executed, including storage and working areas, and to which Plant and Materials are to be delivered, and any other places as may be specified in the Contract as forming part of the Site.
- (o) "Site Manager" means the Contractor's employee appointed by the Contractor to act on behalf of the Contractor as its representative, approved by the AADF and the Independent Engineer/Supervisor and named in the Contractor's bid.
- (p) "Subcontractor" means any party, including any legal successor thereof, which the Contractor has selected to perform part of the Works, but for which the Contractor shall bear full responsibility as per this Contract.
- (q) "Supervisor" means the independent subject (individual or company) appointed by AADF and notified to the Contractor, and that is duly licensed for the supervision of construction works, in the meaning of Law 8402/1998 "On control and regulation of construction works" as amended and its applicable bylaws.
- (r) "Technical Representative" means the duly authorized representative of AADF assigned for overseeing the performance and completion of

ose do të jenë pjesë e Punimeve.

- (k) "Projekti" nënkupton projektin, e financuar nga AADF në përputhje me propozimin dhe buxhetin e miratuar nga Bordi i tij i Drejtorëve.
- (l) "Certifikata e Marrjes së Përkohshme në Dorëzim" nënkupton dokumentin e lëshuar nga Punëdhënësi për Kontraktorin dhe i nënshkruar nga Mbikëqyrësi dhe Kontraktori pas përfundimit të Punimeve dhe nxjerrjes së aktit të kolaudimit, që përcakton pranimin e kushtëzuar nga ana e Punëdhënësit për Punimet e kryera sipas kësaj Kontrate, sipas Periudhës së Garancisë.
- (m) "Grafiku i Punimeve" nënkupton planifikimin e punës, për të cilin është rënë dakord ndërmjet Palëve, në të cilin janë përcaktuar kushtet dhe afatet për realizimin e fazave të veçanta të Punimeve dhe që është pjesë e Propozimit Teknik të Kontraktorit, bashkangjitur si Aneksi III, pjesë përbërëse e Kontratës.
- (n) "Kantieri" nënkupton vendin ku do të kryhen Punimet, ku përshihen hapësirat e vendosjes dhe realizimit të punës, dhe ku do të dorëzohen Pajisjet dhe Materialet, si dhe çdo vend tjetër që mund të specifikohet në Kontratë si pjesë e Kantierit.
- (o) "Menaxheri i Kantierit" nënkupton punonjësin e Kontraktorit të caktuar nga Kontraktori për të vepruar në emër të Kontraktorit si përfaqësues i tij, i miratuar nga AADF dhe Inxhinieri/Mbikëqyrësi i Pavarur dhe i emëruar në ofertën e Kontraktorit;
- (p) "Nën-Kontraktori" nënkupton çdo palë, duke përfshirë çdo pasardhës ligjor të saj, të cilën Kontraktori e ka zgjedhur për të kryer një pjesë të Punimeve, por për të cilën Kontraktori do të mbajë përgjegjësi të plotë sipas kësaj Kontrate.
- (q) "Mbikëqyrësi" nënkupton subjektin e pavarur (individ ose shoqëri) të emëruar nga AADF dhe që i është njoftuar Kontraktorit, i cili është i licencuar rregullisht për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, siç parashikohet nga Ligji 8402/1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, dhe akteve të tij nënligjore në fuqi.
- (r) "Përfaqësuesi Teknik" nënkupton përfaqësuesin e autorizuar të AADF të caktuar për mbikëqyrjen e zbatimit dhe përfundimit të Punimeve, siç

the Works, as set out in this Contract.

- (s) "Warranty Period" means the 24-months period between the issue of the Provisional Acceptance Certificate and the final acceptance of the Works, within which the Employer and Supervisor may request to the Contractor to remedy any defects in the performance of the Works.
- (t) "Works" means the permanent and temporary works which the Employer requires the Contractor to perform as per the tender documents and Detailed Design under this Contract, including but not limited to digging, building, repairing, renovating or installing, as well as services related thereto.

**1.2** In the Contract, except where the context requires otherwise:

- a) the singular includes the plural and vice versa;
- b) reference to one gender includes the other gender;
- c) reference to a law, legal act or sub-legal act, includes reference to that law, legal act or sub-legal act as amended from time to time and to any regulation issued related there.
- d) provisions including the word "agree", "agreed" or "agreement" require the agreement to be recorded in writing;
- e) "written" or "in writing" means hand-written, type-written, printed or electronically made, and resulting in a permanent record; and
- f) the word "tender" is synonymous with "bid" and the words "tender documents" with "bidding documents."
- g) The titles used for the headings, paragraphs, sub-paragraphs, Annexes and table of contents are for reference only and will not affect the interpretation of this Contract.

## **2. SCOPE OF WORK**

**2.1** The purpose of this Contract is to hire a construction company which shall undertake the Works as specified in the Contract and its Annexes, which form an integral part of this Contract.

**2.2** The Contractor also agrees to perform any additionally assigned works, the necessity of which has arisen subsequently, after the signing of this Contract. Such additional works shall be subject to additional payment by AADF, upon

përcaktohet në këtë Kontratë.

- (s) "Periudha e Garancisë" nënkupton periudhën 24-mujore nga lëshimi i Certifikatës së Marrjes së Përkohshme në Dorëzim deri në pranimin përfundimtar të Punimeve, brenda së cilës Punëdhënësi dhe Mbikëqyrësi mund t'i kërkojnë Kontraktorit të riparojë çdo defekt gjatë realizimit të Punimeve.
- (t) "Punimet" nënkupton punimet e përhershme dhe të përkohshme që Punëdhënësi kërkon që Kontraktori të kryejë në bazë të dokumenteve të tenderit dhe Projektit të Detajuar sipas kësaj Kontrate, duke përfshirë por pa u kufizuar në, gërmimin, ndërtimin, riparimin, rinovimin ose instalimin, si dhe shërbimet që lidhen me këto procese.

**1.2** Në Kontratë, përveç rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe:

- a) njëjësi nënkupton shumësin, dhe anasjelltas;
- b) referenca për një gjini nënkupton gjininë tjetër;
- c) referenca ndaj një ligji, akti ligjor ose akti nënligjor përfshin referencën ndaj atij ligji, akti ligjor ose akti nënligjor të ndryshuar herë pas here dhe çdo rregulloreje të nxjerrë në lidhje me të.
- d) dispozitat që përfshijnë fjalët "bie dakord", "dakordësuar" ose "marrëveshje", kërkojnë që marrëveshja të jetë e shkruar;
- e) "i shkruar" ose "me shkrim" do të thotë i shkruar me dorë, i shtypur në kompjuter, i printuar ose i prodhuar në mënyrë elektronike, duke rezultuar në një regjistrim të përhershëm; dhe
- f) "tender" është sinonim me "ofertën", dhe "dokumentet e tenderit" me "dokumentet e ofertës".
- g) Titujt e përdorur për kokat e faqeve, paragrafët, nën-paragrafët, Anekset dhe tabelën e përmbajtjes janë vetëm për referencë dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin e kësaj Kontrate.

## **2. OBJEKTI I KONTRATËS**

**2.1** Qëllimi i kësaj Kontrate është kontraktimi i një shoqërie ndërtimi, e cila do të marrë përsipër realizimin e Punimeve siç specifikohet në Kontratë dhe Anekset e saj, të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj Kontrate.

**2.2** Kontraktori pranon gjithashtu të realizojë çdo punim të caktuar shtesë, domosdoshmëria për të cilin shfaqet në një fazë të mëpasshme, pas nënshkrimit të kësaj Kontrate. Punime shtesë të kësaj natyre do t'i nënshtrohen pagesave shtesë nga AADF, sipas

agreement of the unit prices to be determined in accordance with the Bill of Quantities under Annex I, or otherwise agreed among parties.

### 3. DURATION AND PERIOD OF PERFORMANCE

3.1 This Contract shall be valid from its execution by the Parties until termination of the Warranty Period determined in Clause 5 (the “**Term**”).

3.2 The Completion Date is calculated up to 4 months after the Commencement Date (the “**Period of Performance**”), as per the Schedule of Works in the Contractor Technical Proposal attached in Annex III. Contractor shall commence with the Works only when notified by AADF in writing to do so. AADF is not obligated to reimburse Contractor for any work performed before the Commencement Date.

3.3 The Period of Performance may be extended if the event of delay or impediment for the performance of the Works is not due to the fault of the Contractor. In such case, the Contractor shall be entitled to an excusable non-compensable delay and the Period of Performance shall be prolonged with the number of days of such delay or with number of days necessary for removing such impediment. The period of such an extension shall be approved by a protocol, jointly signed by AADF, the Beneficiary and the Contractor.

3.4 The Contractor acknowledges and accepts that AADF’s role is to provide financing for the realization of the Project as per the terms of this Contract for the benefit of the Beneficiary and as such, the Contractor agrees that AADF shall not be responsible for giving the Contractor right to access to, and possession of, all parts of the Site within the time stated in the Schedule of Works, such responsibilities being under the authority of the Beneficiary. In case the Period of Performance is delayed as a result of an action or inaction of the Beneficiary, the Contractor shall give notice to the Supervisor and shall be entitled only to an extension of time for any such delay, provided that Contractor has taken all necessary measures to fulfil its responsibilities as per Clause 10.4 for the completion of the Works within the Period of Performance.

3.5 The Supervisor, after prior written approval of

marrëveshjes për çmimet njësi që do të përcaktohen në përputhje me Preventivin sipas Aneksit I ose siç mund të dakordësohet ndryshe mes palëve.

### 3. KOHËZGJATJA DHE PERIUDHA E PËRMBUSHJES SË KONTRATËS

3.1 Kjo Kontratë do të jetë e vlefshme nga data e nënshkrimit të saj nga Palët deri në përfundimin e Periudhës së Garancisë që përcaktohet në Nenin 5 (“**Afati**”).

3.2 Data e Përfundimit do të jetë brenda 4 muajve nga Data e Fillimit (“**Periudha e Përmbushjes së Kontratës**”), sipas Grafikut të Punimeve në Propozimin Teknik të Kontraktorit bashkangjitur si Aneksi III. Kontraktori do të fillojë me Punimet vetëm kur të njoftohet me shkrim nga AADF për të bërë një gjë të tillë. AADF nuk është i detyruar të rimburojë Kontraktorin për punimet e kryera përpara Datës së Fillimit.

3.3 Periudha e Përmbushjes së Kontratës mund të zgjatet nëse vonesa ose pengesa për realizimin e Punimeve nuk ndodh për faj të Kontraktorit. Në këtë rast, Kontraktori do të ketë të drejtën e një vonese të justifikueshme të pakompensueshme dhe Periudha e Përmbushjes së Kontratës do të shtyhet aq ditë sa ka qenë kohëzgjatja e vonesës ose aq ditë sa nevojiten për eliminimin e kësaj pengese. Periudha e një zgjatjeje të tillë do të miratohet me një protokoll, që do të nënshkruhet bashkërisht nga AADF, Përfituesi dhe Kontraktori.

3.4 Kontraktori pranon se roli i AADF është të financojë realizimin e Projektit sipas kushteve dhe afateve të kësaj Kontrate në dobi të Përfituesit dhe në këtë mënyrë, Kontraktori bie dakord që AADF nuk do të mbajë përgjegjësi për t’i dhënë Kontraktorit të drejtën për akses dhe zotërim të të gjitha pjesëve të Kantierit brenda kohëzgjatjes së përcaktuar në Grafikon e Punimeve, përgjegjësi që bien nën autoritetin e Përfituesit. Në rast se Periudha e Përmbushjes së Kontratës shtyhet për shkak të një veprimi ose mosveprimi të Përfituesit, Kontraktori do të njoftojë Mbikëqyrësin dhe do të ketë të drejtë vetëm për zgjatje kohore për çdo vonesë të tillë, me kusht që Kontraktori të ketë marrë të gjitha masat e nevojshme për të përmbushur përgjegjësitë e tij sipas Nenit 10.4 për përfundimin e Punimeve brenda Periudhës së Përmbushjes së Kontratës.

3.5 Mbikëqyrësi, pas miratimit paraprak me shkrim të

Employer, may at any time instruct or order the Contractor to suspend the progress of part or all of the Works, which instruction or order shall state the date and cause of the suspension. During such suspension, the Contractor shall protect, store and secure such part or all of the Works (as the case may be) against any deterioration, loss or damage. The Contractor herein agrees that any costs that may be incurred by the latter due to the suspension of the Works, including measures taken for their protection, storing and securing as required under the Contract, are included in the Contract Price and the Contractor shall not be entitled to any additional payments by AADF.

#### **4. PAYMENT TERMS**

##### **4.1 Contract Price Calculation and Payment**

The Works specified in this Contract will be financed entirely by the AADF. The Contract Price is [insert] VAT excluded. AADF shall make payments to Contractor in base of actual Works completed. The invoice will be calculated using the items fixed prices agreed to by both Parties and as stated in Annex I of the Contract, Bill of Quantities. In case there is a need for additional Works for which there is no reference price in the Contract, an amendment to this Contract is made through a Change Order. AADF shall pay Contractor, after submission of proper invoices, documentation and appropriate approvals, the full approved invoiced amount less any withholdings as set forth in Clause 5 "Retention and Warranty Period", or Clause 15 "Liquidated Damages".

##### **4.2 Invoice Requirements**

Contractor shall present to AADF an invoice only for Works provided by the Contractor and which quantities and quality have been approved and accepted by the Supervisor. Contractor shall include with each invoice submitted for payment a certification as indicated below. To constitute a proper invoice, the invoice must include the following information and/or attached documentation:

- (1) Contractor name and Tax ID Number, Contract number, invoice date, and invoice number;
- (2) AADF's name and Tax ID Number;
- (3) Description of approved deliverable(s) and corresponding volumes, price(s) and total value;
- (4) Calculation of any required withholdings;
- (5) Bank account name, number and IBAN to

Punëdhënësit, mund të instruktojë ose urdhërojë në çdo kohë Kontraktorin të pezullojë vazhdimin e një pjese ose të të gjitha Punimeve. Në këtë instruksion ose urdhër do të saktësohet data dhe shkaku i pezullimit. Gjatë një pezullimi të tillë, Kontraktori do të ruajë, magazinojë dhe sigurojë një pjesë ose të gjitha Punimet (sipas rastit), kundër amortizimit, humbjes apo dëmtimit. Sipas kësaj Kontrate, Kontraktori bie dakord që të gjitha kostot që mund të ketë për shkak të pezullimit të Punimeve, duke përfshirë masat për ruajtjen, magazinimin dhe sigurimin e tyre siç parashikohet në Kontratë, përfshihen në Çmimin e Kontratës dhe Kontraktori nuk do të ketë të drejtë të kërkojë asnjë pagesë shtesë nga AADF.

#### **4. KUSHTET E PAGESËS**

##### **4.1 Llogaritja e Çmimit të Kontratës dhe Pagesa**

Punimet e përcaktuara në këtë Kontratë do të financohen tërësisht nga AADF. Çmimi i Kontratës është [vendos], pa TVSH. AADF do t'i bëjë pagesat Kontraktorit në bazë të Punimeve faktike të përfunduara. Fatura do të llogaritet duke iu referuar çmimeve fikse të zërave, për të cilat është rënë dakord nga të dyja Palët dhe ashtu siç përcaktohet në Aneksin I të Kontratës, Preventivi. Në rast se nevojiten Punime shtesë për të cilat nuk ka çmim reference në Kontratë, kësaj Kontrate do t'i bëhet një ndryshim nëpërmjet një Urdhri Ndryshimi. Pas dorëzimit të faturave, dokumentacionit dhe miratimeve të duhura dhe përkatëse, AADF do t'i paguajë Kontraktorit shumën e plotë të miratuar, duke zbritur çdo shumë të mbajtur, siç përcaktohet në Nenin 5 " Periudha dhe Vlera e Mbajtur e Garancisë" ose Nenin 15 "Dëmet e Likuiduara".

##### **4.2 Kërkesat për Faturën**

Kontraktori duhet t'i paraqesë AADF një faturë vetëm për Punimet që janë realizuar nga Kontraktori dhe sasi të cilësia e të cilave janë miratuar dhe pranuar nga Mbikëqyrësi. Kontraktori duhet ta shoqërojë çdo faturë të dorëzuar për pagesë me një vërtetim siç specifikohet më poshtë. Një faturë e plotë duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm dhe/ose dokumentacionin e bashkangjitur:

- (1) Emrin e Kontraktorit dhe NIPT-in, numrin e Kontratës, datën e faturës dhe numrin e faturës;
- (2) Emrin dhe NIPT-in e AADF;
- (3) Përshkrimin e produktit/produkteve të miratuara dhe sasive përkatëse, çmimit/çmimeve dhe vlerës totale;
- (4) Llogaritjen e çdo shume të mbajtur;
- (5) Emrin, numrin dhe IBAN-in e llogarisë bankare, ku

which payment shall be made;  
(6) Contractor Certification as per Annex V of the Contract.

#### **4.3 Submission of Invoices**

Contractor shall submit invoices and all required attachments to the Technical Representative, after approval by the Supervisor (bill of measures and any other appropriate documents as required by Supervisor and/or Technical Representative), in hard and soft copy, who will follow the appropriate verification and payment procedures. Any invoices for services rendered and deliverables submitted, but not accepted by AADF, will not be paid until Contractor makes sufficient revisions to the deliverables such that AADF may approve the deliverables and thus the invoice. Should the Supervisor and/or Technical Representative find differences for Works certified and paid, which had not been noticed earlier by the above parties, they shall be deducted from the subsequent interim payment certificate.

#### **4.4 Payment term**

Invoices will be paid within 30 calendar days after being accepted by AADF and after submission of the VAT invoice by Contractor. Each Party shall bear its own bank's charges (shared fees).

#### **4.5 Taxes and Duties**

Contractor is liable for payment of all applicable taxes, as prescribed under the applicable laws, associated with wages/salaries/compensation for services rendered by individuals employed by Contractor and who are directed to work on the construction as required under this Contract.

Contractor is liable for payment of all applicable taxes associated with revenues (profit), and other such taxes, fees, or dues for which Contractor is normally responsible as a result of operating its business including VAT-Value Added Tax.

### **5. RETENTION AND WARRANTY PERIOD**

#### **5.1 Warranty period**

The Contractor undertakes to issue two-year warranty, that shall be effective from the signing of the Provisional Acceptance Certificate following acceptance of the Works, and to

do të bëhet pagesa;  
(6) Vërtetimin nga Kontraktori sipas Aneksit V të Kontratës.

#### **4.3 Dorëzimi i Faturave**

Kontraktori do t'ia dorëzojë faturat dhe të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar Përfaqësuesit Teknik, pas miratimit nga Mbikëqyrësi (librezat e masave dhe çdo dokument tjetër të përshtatshëm, siç kërkohet nga Mbikëqyrësi dhe/ose Përfaqësuesi Teknik), në formë fizike dhe elektronike, i cili do të ndjekë procedurat e duhura të verifikimit dhe pagesës. Të gjitha faturat për shërbimet e kryera dhe produktet e dorëzuara, por të papranuara nga AADF, do të paguhen vetëm kur Kontraktori të realizojë rishikimet e nevojshme deri në atë masë sa AADF t'i miratojë këto produkte, dhe rrjedhimisht edhe faturën përkatëse. Nëse Mbikëqyrësi dhe/ose Përfaqësuesi Teknik konstatojnë diferenca mes Punimeve të certifikuara dhe Punimeve të paguara, të cilat nuk janë pikasur më parë nga palët e mësipërme, këto diferenca do të zbriten nga situacioni pjesor pasues.

#### **4.4 Afati i pagesës**

Faturat do të paguhen brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit nga AADF dhe pas dorëzimit të faturës tatimore me TVSH nga Kontraktori. Çdo Palë do të mbajë përgjegjësi për shlyerjen e tarifave të bankës së vet (komisione të ndara).

#### **4.5 Taksat dhe Detyrimet**

Kontraktori është përgjegjës për shlyerjen e të gjitha taksave dhe tatimeve të zbatueshme, siç parashikohen sipas ligjeve në fuqi, të cilat lidhen me pagat/pagesat/kompensimet për shërbimet e kryera nga individë që janë punësuar nga Kontraktori dhe që janë udhëzuar të realizojnë Punime sipas kësaj Kontrate.

Kontraktori është përgjegjës për shlyerjen e të gjitha taksave dhe tatimeve të zbatueshme që lidhen me të ardhurat (fitimin), si dhe tatimet, tarifatat ose detyrimet e tjera, për të cilat Kontraktori është normalisht përgjegjës për shkak të funksionimit të biznesit të tij, duke përfshirë TVSH – Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

### **5. PERIUDHA DHE VLERA E MBAJTUR E GARANCISË**

#### **5.1 Periudha e Garancisë**

Kontraktori merr përsipër të lëshojë garanci dyvjeçare, e cila do të hyjë në fuqi në momentin e nënshkrimit të Certifikatës së Marrjes së Përkohshme në Dorëzim, pas pranimit të Punimeve, si dhe të

remedy, at its own expenses, any possible defects during the Warranty Period.

## 5.2 Retention

AADF shall retain 10% (ten percent) from each payment (VAT excluded) due to Contractor, as guarantee for the quality of their completed Works. This amount will be payable at the end of each warranty year in equal tranches, 5% after the first warranty year and the rest at the end of the warranty period following the inspection after each year of the Site by both Parties and repair of any founds defects, if any. AADF shall return the retained amount to Contractor as per the above schedule, provided the Works have been performed in compliance with this Contract and that the Contractor duly performed any repairs, as may be required by AADF in writing. Should the Contractor fail to honor the warranty conditions and repair any possible defects or damages as necessary within the term notified by AADF, without prejudice to any other rights under the Contract, AADF has the right to perform such repairs through a third party and shall deduct relevant expenses from the 10% guarantee.

## 6. PLANT AND MATERIALS

**6.1** All Plant and Materials incorporated into the Works covered by this Contract shall be new and of the most suitable grade for the purpose intended, unless otherwise specifically provided for in this Contract. AADF may specify brands of Plant and Materials to be used. In this case, Contractor is obligated to follow such specifications. In no case AADF will specify brands with the intention to favor a specific supplier but rather to guarantee the quality. In special cases, the Technical Representative may approve usage of other brands that are established to be equal or better in the specifications and quality to those named. When a specific brand is mentioned in the Contract or its annexes, the Contractor will need to receive prior written approval by AADF for changing brand. AADF is not obliged to pay for any expense incurred by Contractor prior to this approval.

**6.2** Contractor shall not use equipment in violation of Clause 23.11.

**6.3** The Contractor shall carry out the tests necessary

mbulojë, me shpenzimet e veta, çdo defekt të mundshëm gjatë Periudhës së Garancisë.

## 5.2 Vlera e Mbajtur e Garancisë

AADF do të mbajë 10% (dhjetë për qind) nga çdo pagesë (pa TVSH) që i bëhet Kontraktorit, si garanci për cilësinë e Punimeve të përfunduara. Kjo shumë do të paguhet në fund të çdo viti garancie në këste të barabarta, 5% pas vitit të parë të garancisë dhe pjesa tjetër në fund të Periudhës së Garancisë, pas inspektimit të Kantierit në fund të çdo viti nga të dyja Palët dhe pas riparimit të çdo defekti të konstatuar, nëse ka. AADF do t'ia kthejë Kontraktorit shumën e mbajtur sipas planit të mësipërm, me kusht që Punimet të jenë realizuar në përputhje me këtë Kontratë dhe që Kontraktori të ketë kryer çdo riparim, siç mund të kërkohet nga AADF me shkrim. Në qoftë se Kontraktori nuk respekton kushtet e garancisë dhe nuk riparon ndonjë defekt ose dëmtim të mundshëm sipas nevojës brenda afatit të njoftuar nga AADF, pa cenuar çdo të drejtë tjetër sipas Kontratës, AADF ka të drejtën t'i kryejë këto riparime përmes një pale të tretë dhe do të zbresë shpenzimet përkatëse nga garancia 10%.

## 6. PAJISJET DHE MATERIALET

**6.1** Pajisjet dhe të gjitha materialet e përfshira në Punimet e mbuluara nga kjo Kontratë do të jenë të reja dhe në gjendjen më të përshtatshme për qëllimin e përdorimit të synuar, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në mënyrë specifike në këtë Kontratë. AADF mund të specifikojë markat e pajisjeve dhe materialeve që do të përdoren. Në këtë rast, Kontraktori është i detyruar të respektojë këto specifikime. Në asnjë rast, AADF nuk do të specifikojë markat me qëllim që të favorizojë një furnitor të veçantë, por për të garantuar cilësinë. Në raste të veçanta, Përfaqësuesi Teknik mund të miratojë përdorimin e markave të tjera të njohura që janë të konsoliduara në treg, dhe të cilat, sa i përket specifikimeve teknike dhe cilësisë, janë të njëjta ose më të mira sesa ato që janë përcaktuar. Kur një markë specifike përmendet në Kontratë ose anekset e saj, Kontraktori do të duhet të marrë miratimin paraprak me shkrim nga AADF për ndryshimin e markës. AADF nuk është i detyruar të paguajë asnjë shpenzim të kryer nga Kontraktori përpara këtij miratimi.

**6.2** Kontraktori nuk do të përdorë pajisjet në shkelje të nenit 23.11.

**6.3** Kontraktori do të kryejë testet e nevojshme për të

to ensure that the quality of Plants, Materials, workmanship and the end product is in line with the requirements of this Contract, the Detailed Design standard and quality. All testing shall be carried out in accordance with the Detailed Design or as requested by the Employer. The Contractor shall give prior notice to Supervisor and Technical Representative, stating the time and place for the specified testing of any Plant, Materials and other parts of the Works, for the latter to attend. The Supervisor may vary the location and timing or details of the specified tests, or instruct the Contractor to carry out additional tests, as may be considered necessary to confirm the adequacy of the Works. The Supervisor shall supervise such tests, record the test measurements and verify the adequacy or otherwise of the results. In addition, Contractor shall obtain prior approval of the Employer for any Plant or Materials to be used in the Works. In case of realization of Works that have not been approved by the Supervisor and/or the Technical Representative, the Contractor shall comply with Supervisor's instruction for remedial works in accordance with Clause 9.4. Contractor shall bear the cost of all required remedial work.

## **7. QUANTITY SURVEYS**

**7.1** Quantity surveys shall be conducted, and the data derived from these surveys shall be used in computing the quantities of Works performed and the actual construction completed and in place. AADF reserves the right to conduct such surveys. However, it is required that Contractor conducts the original and final surveys and surveys for any periods for which interim payments are requested.

**7.2** Upon completion of surveys, Contractor shall furnish the originals of all field notes and all other records relating to the survey or to the layout of the Works to the Supervisor who shall use them as necessary to determine the value of interim payments. After verification and approval from the Supervisor, the latter shall submit these surveys to the Technical Representative to proceed with the relevant payment. Contractor shall retain copies of all such materials submitted to the Technical Representative and/or Supervisor.

siguruar që cilësia e Pajisjeve, Materialeve, punëtorisë dhe produktit përfundimtar është në përputhje me kërkesat e kësaj Kontrate, si dhe standardin dhe cilësinë e Projektit të Detajuar. Të gjitha testimet do të kryhen në përputhje me Projektin e Detajuar ose siç kërkohet nga Punëdhënësi. Kontraktori do t'iu bëjë njoftim paraprak Mbikëqyrësit dhe Përfaqësuesit Teknik, në të cilin do të saktësojë kohën dhe vendin ku do të bëhet testimi i specifikuar i Pajisjeve, Materialeve dhe pjesëve të tjera të Punimeve, në mënyrë që këta të fundit të jenë të pranishëm. Mbikëqyrësi mund të ndryshojë vendndodhjen dhe kohën apo detajet e testeve të specifikuara, ose mund të udhëzojë Kontraktorin të kryejë teste shtesë, siç mund të gjykohet e nevojshme në mënyrë që të konfirmohet përshtatshmëria e Punimeve. Mbikëqyrësi do të monitorojë këto teste, do të regjistrojë matjet e gjeneruara prej tyre dhe do të verifikojë përshtatshmërinë ose jo të rezultateve. Përveç kësaj, Kontraktori do të marrë miratimin paraprak të Punëdhënësit për çdo Pajisje ose Material që do të përdoret për Punimet. Në rast të realizimit të Punimeve që nuk janë miratuar nga Mbikëqyrësi dhe/ose Përfaqësuesi Teknik, Kontraktori do të respektojë udhëzimin e Mbikëqyrësit për realizimin e punimeve korrigjuese në përputhje me nenin 9.4. Kontraktori do të mbulojë koston e të gjitha punimeve të nevojshme korrigjuese.

## **7. MATJET E SASIVE**

**7.1** Do të kryhen matje të sasive, dhe të dhënat e nxjerra nga këto matje do të përdoren për llogaritjen e sasive/volumeve të Punimeve të kryera dhe ndërtimit realisht të përfunduar. AADF ruan të drejtën të kryejë matje të tilla. Megjithatë, kërkohet që Kontraktori të kryejë matjet fillestare dhe përfundimtare, si dhe matje për çdo periudhë për të cilën kërkohen pagesa të ndërmjetme.

**7.2** Pas përfundimit të matjeve, Kontraktori do t'i japë Mbikëqyrësit dokumentet origjinale të shënimeve të marra në terren dhe të gjitha shënimet e tjera në lidhje me matjet ose planvendosjet e Punimeve ose planet piketimin e Punimeve, i cili do t'i përdorë ato, sipas nevojës, për të përcaktuar vlerën e pagesave të ndërmjetme. Pas verifikimit dhe miratimit nga Mbikëqyrësi, ky i fundit ia dorëzon dokumentacionin e këtyre matjeve Përfaqësuesit Teknik për të vijuar me pagesën përkatëse. Kontraktori do të mbajë kopje të të gjitha materialeve të tilla të dorëzuara te Përfaqësuesi Teknik dhe/ose Mbikëqyrësi.

## **8. PROJECT SUPERVISION**

- 8.1** Contractor shall deliver the required Works, goods and services stipulated herein subject to the general technical direction of the Supervisor appointed by the AADF as stated in the Contract and recommendations of the Aesthetical Supervisor. The Supervisor will be responsible for monitoring Contractor's performance under this Contract.
- 8.2** In the course of the performance of this Contract, AADF through the Technical Representative and the Aesthetical Supervisor, shall exercise timely and ongoing investor's supervision over any and all Works as per this Contract.
- 8.3** Supervisor's job description is defined to include:
- (1) Written directions to Contractor that adds or clarifies details or otherwise facilitates completion of the Works;
  - (2) Provision of written information to Contractor which assists in the interpretation of drawings, specifications, or technical portions of the statement of work;
  - (3) Review and, where required, provide written approval of technical reports, drawings, specifications or technical information to be delivered;
  - (4) Sign and authorize the bill of quantities;
  - (5) Sign together with the Technical Representative the Provisional Acceptance Certificate.
  - (6) Initiate change orders to be approved by the AADF.
- 8.4** The Supervisor holds monthly meetings in presence of the Technical Representative and the Contractor. The Supervisor keeps the minutes for each meeting and sends them in writing by e-mail to the Technical Representative and the Contractor. Failure by the Technical Representative and the Contractor to provide any feedback on the minutes of the meeting within 2 (two) working days from their receipt, shall be considered as approval of such minutes and the Supervisor submits them for signature by all parties and the Contractor. The minutes of the meetings shall constitute official documents on the construction works progress and performance of this Contract.
- 8.5** Contractor undertakes, upon request by the Technical Representative or the Supervisor, to

## **8. MBIKËQYRJA E PROJEKTIT**

- 8.1** Kontraktori do të dorëzojë Punimet, mallrat dhe shërbimet e kërkuara të përcaktuara në këtë Kontratë në përputhje me udhëzimet teknike të përgjithshme të Mbikëqyrësit të caktuar nga AADF, siç parashikohet në Kontratë, dhe rekomandimet e Mbikëqyrësit Estetik. Mbikëqyrësi do të jetë përgjegjës për monitorimin e performancës së Kontraktorit, sipas kësaj Kontrate.
- 8.2** Gjatë zbatimit të kësaj Kontrate, AADF, nëpërmjet Përfaqësuesit Teknik dhe Mbikëqyrësit Estetik, do të ushtrojë mbikëqyrje investitori të rregullta dhe të vazhdueshme për të gjitha Punimet sipas kësaj Kontrate.
- 8.3** Detyrat e Mbikëqyrësit përfshijnë:
- (1) T'i japë udhëzime me shkrim Kontraktorit, i cili shton ose sqaron detaje, si dhe lehtëson përfundimin e Punimeve;
  - (2) T'i japë informacione me shkrim Kontraktorit për të ndihmuar në interpretimin e vizatimeve, specifikimeve ose pjesëve teknike të deklaratës së punimeve;
  - (3) Të rishikojë dhe, ku i kërkohet, të ofrojë miratim me shkrim të raporteve teknike, vizatimeve, specifikimeve ose informacionit teknik që do të dorëzohet;
  - (4) Të nënshkruajë dhe autorizojë Preventivin e punimeve;
  - (5) Të nënshkruajë së bashku me Përfaqësuesin Teknik Certifikatën e Marrjes së Përkohshme në Dorëzim;
  - (6) Të iniciojë urdhrat e ndryshimit që do të miratohen nga AADF.
- 8.4** Mbikëqyrësi zhvillon mbledhje mujore me prezencën e Përfaqësuesit Teknik dhe Kontraktorit. Mbikëqyrësi mban procesverbal takimi për çdo mbledhje dhe ia dërgon me e-mail Përfaqësuesit Teknik dhe Kontraktorit. Në rast se Përfaqësuesi Teknik dhe Kontraktori nuk japin ndonjë koment për procesverbalin e takimit brenda 2 (dy) ditë pune nga marrja e tij, atëherë ky dokument do të konsiderohet i miratuar dhe Mbikëqyrësi ia dorëzon të gjitha palëve dhe Kontraktorit për nënshkrim nga ana e tyre. Procesverbalet e takimeve do të konsiderohen dokumente zyrtare mbi ecurinë e punimeve të ndërtimit dhe zbatimin e kësaj Kontrate.
- 8.5** Kontraktori merr përsipër që, me kërkesë të Përfaqësuesit Teknik ose Mbikëqyrësit, t'u japë akses

- grant access to any work places, workshops and storage areas, where Works, or parts thereof, are performed as per this Contract or where materials and furniture components are stored.
- 8.6** Instructions and orders by the Supervisor shall be binding for the Contractor. Technical directions of the Supervisor must be in writing and must be consistent with the statement of work set forth in this Contract.
- 8.7** The Contractor shall be obliged to ensure to the Technical Representative, Aesthetical Supervisor and the Supervisor every opportunity to inspect and measure any Works that are scheduled to be covered up. The Contractor must notify the Technical Representative and the Supervisor whenever such Works are ready or almost ready for inspection, or are going to be paid, by issuing a Request for Inspection (RFI).
- 8.8** The Supervisor, within 24 (twenty-four) hours must, without undue delay, undertake steps to inspect and measure such Works. The RFI constitutes the official document based on which, Supervisor shall reflect if the Works are accepted or not. The RFI is part of the supporting documentation for purposes of effectuating the interim payments. Within 30 (thirty) calendar days from receipt of interim payment certificate and supporting documentation as per the applicable law, the Supervisor shall have the right to comment, refuse, correct or approve the interim payment certificate. Should the Supervisor have any comments on the interim payment certificate or request to complete the supporting documentation, as deemed necessary by the Supervisor, such comments/requests are notified in writing to the Contractor and the Contractor shall correct or replace it and submit the revised interim payment certificate and/or complete the documentation to the Supervisor within 5 days from the notification. Within 5 days from receipt of the corrected or replaced interim payment certificate, the Supervisor shall certify or refuse the interim payment certificate.
- 8.9** The inspections done by the Technical Representative, the Supervisor or by any other authorized person shall not be considered as approval of the Materials or Works, unless the Supervisor and Technical Representative confirm this in writing and specifying: the date of the inspection; the portion of the Works, which has
- në çdo vend pune dhe zona magazinimi ku realizohen Punimet ose pjesë e tyre sipas kësaj Kontrate, ose ku ruhen materialet apo pajisjet e ndryshme.
- 8.6** Instruksionet dhe urdhrat e Mbikëqyrësit do të jenë të detyrueshme për Kontraktorin. Udhëzimet teknike të Mbikëqyrësit duhet të bëhen me shkrim dhe duhet të jenë në përputhje me deklaratën e punimeve të përcaktuar në këtë Kontratë.
- 8.7** Kontraktori është i detyruar t'iu sigurojë Përfaqësuesit Teknik, Mbikëqyrësit Estetik dhe Mbikëqyrësit të gjitha mundësitë për të inspektuar dhe matur çdo Punim të planifikuar për t'u mbuluar. Kontraktori duhet të njoftojë Përfaqësuesin Teknik dhe Mbikëqyrësin sa herë që këto Punime të jenë gati ose pothuajse gati për t'u inspektuar, ose sa herë që do të paguhen, duke lëshuar një Kërkesë për Inspektim (KPI).
- 8.8** Brenda 24 (njëzet e katër) orëve, pa vonesa të panevojshme, Mbikëqyrësi duhet të ndërmarrë hapa për të inspektuar dhe për të kryer matjet e këtyre Punimeve. KPI përbën dokumentin zyrtar në bazë të të cilit, Mbikëqyrësi përcakton nëse Punimet pranohen ose jo. KPI është pjesë e dokumentacionit mbështetës për kryerjen e pagesave të ndërmjetme. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga marrja e situacionit pjesor, së bashku me dokumentacionin mbështetës sipas legjislacionit të zbatueshëm, Mbikëqyrësi ka të drejtë të komentojë, refuzojë, korrigjojë ose miratojë këtë situacion. Nëse Mbikëqyrësi ka ndonjë vërejtje për situacionin apo kërkesë për plotësimin e dokumentacionit mbështetës, siç gjykohet e nevojshme nga Mbikëqyrësi, këto komente/kërkesa i njoftohen me shkrim Kontraktorit dhe Kontraktori duhet ta korrigjojë ose zëvendësojë atë dhe t'i dorëzojë Mbikëqyrësit situacionin e rishikuar dhe/ose plotësojë dokumentacionin brenda 5 ditëve nga data e njoftimit. Brenda 5 ditëve nga marrja e situacionit të korrigjuar ose zëvendësuar, Mbikëqyrësi do të certifikojë ose refuzojë situacionin.
- 8.9** Inspektimet e kryera nga Përfaqësuesi Teknik, Mbikëqyrësi ose nga ndonjë person tjetër i autorizuar nuk do të konsiderohen si miratim i Materialeve ose Punimeve, përveç nëse Mbikëqyrësi dhe Përfaqësuesi Teknik e konfirmojnë këtë me shkrim dhe specifikojnë: datën e inspektimit; pjesën e Punimeve që është inspektuar; rrethana të tjera.

been inspected; other conditions.

## **9. DELIVERY AND ACCEPTANCE OF THE WORKS**

### **9.1 Manner of Execution**

Contractor shall perform all Works under this Contract in a skillful and workmanlike manner. The Technical Representative and/or Supervisor reserves the right to request the removal of any Contractor employee who is deemed to be incompetent, careless, or otherwise objectionable.

### **9.2 Construction Schedule**

9.2.1 The Works shall be performed in stages as reflected in the Schedule of Works included in the Contractor Technical Proposal attached as Annex III of the Contract.

9.2.2 The Contractor, shall, within 10 working days after the effective date of this Contract or another period of time determined by the Technical Representative, prepare and submit for approval to the Technical Representative and Supervisor three (3) copies of a practicable schedule showing the order in which Contractor proposes to perform the Works, and the dates on which Contractor contemplates starting and completing the several salient features of the Work (including acquiring materials, plant, and equipment) in compliance with the Schedule of Works under Annex III. The schedule shall be in the form of a critical path chart of suitable scale to indicate appropriately the percentage of work scheduled for completion by any given date during the period. If Contractor fails to submit a schedule within the time prescribed, the Technical Representative may withhold approval of payments until Contractor submits the required schedule.

9.2.3 If, in the opinion of the Technical Representative and/or Supervisor, Contractor falls behind the approved schedule, Contractor shall take steps necessary to improve its progress, including those that are required by the Technical Representative and/or Supervisor, without additional cost to the AADF. In such circumstance, the Technical Representative and/or

## **9. DORËZIMI DHE PRANIMI I PUNIMEVE**

### **9.1 Mënyra e Zbatimit**

Kontraktori do të kryejë të gjitha Punimet sipas kësaj Kontrate me kompetencë, profesionalizëm dhe cilësi. Përfaqësuesi Teknik dhe/ose Mbikëqyrësi ka të drejtën të kërkojë largimin e çdo punonjësi të Kontraktorit, i cili gjykohet i paaftë, i shkujdesur ose problematik.

### **9.2 Grafiku i Punimeve**

9.2.1 Punimet do të kryhen në faza siç pasqyrohet në Grafikon e Punimeve që përfshihet në Propozimin Teknik të Kontraktorit bashkangjitur si Aneksi III i Kontratës.

9.2.2 Kontraktori, brenda 10 ditëve punë pas hyrjes në fuqi të kësaj Kontrate ose në një periudhë tjetër të përcaktuar nga Përfaqësuesi Teknik, do të përgatisë dhe do t'i dorëzojë për miratim Përfaqësuesit Teknik dhe Mbikëqyrësit tre (3) kopje të një plani real që tregon rendin në të cilin Kontraktori propozon zbatimin e Punimeve dhe datat kur Kontraktori synon të fillojë dhe të realizojë disa nga aspektet më thelbësore të Punimeve (përfshirë blerjen e materialeve, pajisjeve dhe makinerive), në përputhje me Grafikon e Punimeve sipas Aneksit III. Ky plan do të jetë në formën e një grafiku, i cili do të paraqesë në mënyrë të përshtatshme përqindjen e punës së planifikuar për t'u përfunduar në çdo datë të caktuar gjatë kësaj periudhe. Nëse Kontraktori nuk e dorëzon këtë plan brenda kohës së përcaktuar, Përfaqësuesi Teknik mund të ndërpresë miratimin e pagesave derisa Kontraktori të dorëzojë planin e kërkuar.

9.2.3 Nëse, sipas opinionit të Përfaqësuesit Teknik dhe/ose Mbikëqyrësit, Kontraktori nuk përmbush punën brenda afateve të përcaktuara në grafikonin e miratuar, Kontraktori do të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të përmirësuar ecurinë e tij, duke përfshirë ato hapa që kërkohen nga Përfaqësuesi Teknik dhe/ose Mbikëqyrësi, pa kosto shtesë për AADF-në. Në rrethana të tilla, Përfaqësuesi Teknik dhe/ose

Supervisor may require Contractor to increase the number of employees, shifts, overtime operations, days of work, and/or the amount of construction plant, and to submit schedules in chart form as the Technical Representative and/or Supervisor deems necessary to demonstrate how the project will recoup lost time and get back on schedule to finish within the specified time of this Contract.

9.2.4 Failure of Contractor to comply with the requirements of the Technical Representative and/or Supervisor under this clause shall be grounds for a determination by the Technical Representative and/or the Supervisor that Contractor is not executing the Works with sufficient diligence to ensure completion within the time specified in this Contract. Upon making this determination, the AADF may terminate Contractor's right to proceed with the Works, or any separable part of it, in accordance with sub-clause 21.1.3 of the Contract, without prejudice to any other rights of AADF under this Contract.

### 9.3 Inspection of the Works

The extent and character of the work to be done by Contractor shall be subject to the general oversight, supervision, direction, control, and approval of the Technical Representative and Supervisor. Contractor shall submit to Employer evidence that the Works are performed within the standards required in the Detailed Design. Should the Technical Representative or the Supervisor consider that other additional tests, surveys or inspections are necessary, the Contractor shall be responsible to perform them at its own costs and expenses. Inspection and acceptance of all deliverables provided under this Contract shall be made by both, Technical Representative and the Supervisor. AADF will accept deliverables on the basis of criteria set forth in this Contract, as well as in any pertinent attachments. AADF will retain payment on deliverables that are determined to be unacceptable and will advise Contractor in writing of deficiencies.

Mbikëqyrësi mund të kërkojë që Kontraktori të shtojë numrin e punonjësve, turneve, punimet jashtë orarit zyrtar, ditët e punës dhe/ose sasinë e pajisjeve të ndërtimit, si dhe të dorëzojë plane të paraqitura në formë grafike, siç e gjykon të nevojshme Përfaqësuesi Teknik dhe/ose Mbikëqyrësi, me qëllim që të demonstrojë se si do të rikuperojë kohën e humbur dhe do të realizojë Punimet brenda afateve të parashikuara në Kontratë.

9.2.4 Në rast se Kontraktori nuk përmbush kërkesat e Përfaqësuesit Teknik dhe/ose Mbikëqyrësit sipas këtij Neni, Përfaqësuesi Teknik dhe/ose Mbikëqyrësi do të kenë arsye për të vendosur se Kontraktori nuk po kryen Punimet me përgjegjësinë e duhur për të garantuar përfundimin e Punimeve brenda periudhës së përcaktuar në këtë Kontratë. Me marrjen e këtij vendimi, AADF mund t'ia heqë të drejtën Kontraktorit për vazhdimin e Punimeve ose një pjese të veçantë të tyre, në përputhje me pikën 21.1.3 të Kontratës, pa cenuar të drejtat e tjera të AADF sipas kësaj Kontrate.

### 9.3 Inspektimi i Punimeve

Realizimi në kohë dhe natyra e punimeve që do të kryhet nga Kontraktori, do të jetë objekt i vëzhgimit të përgjithshëm, mbikëqyrjes, drejtimit, kontrollit dhe miratimit të Përfaqësuesit Teknik dhe Mbikëqyrësit. Kontraktori duhet t'i paraqesë Punëdhënësit dëshmi që vërtetojnë se Punimet janë realizuar brenda standardeve të përcaktuara në Projektin e Detajuar. Në rast se Përfaqësuesi Teknik ose Mbikëqyrësi vendos se nevojiten testime, rievime apo inspektime shtesë, Kontraktori është përgjegjës për t'i realizuar ato me kostot dhe shpenzimet e veta. Inspektimi dhe pranimi i të gjitha produkteve të parashikuara sipas kësaj Kontrate do të bëhet si nga Përfaqësuesi Teknik ashtu edhe nga Mbikëqyrësi. AADF do të pranojë produktet në bazë të kriterëve të përcaktuara në këtë Kontratë, si dhe në dokumentacionin përkatës bashkëlidhur. AADF do të mbajë pjesë të pagesës për produktet që janë përcaktuar si të papranueshme, dhe do të këshillojë me shkrim Kontraktorin për mangësitë përkatëse.

#### **9.4 Remedial Work**

Notwithstanding any previous test or certification, the Supervisor may instruct the Contractor to:

- (a) remove from the Site and replace any Plant or Materials which is not in accordance with the Contract,
- (b) remove and re-execute any other work which is not in accordance with the Contract, and
- (c) execute any work which is urgently required for the safety of the Works, whether because of an accident, unforeseeable event or otherwise.

The Contractor shall comply with the instruction within a reasonable time, which shall be the time (if any) specified in the instruction, or immediately if urgency is specified under sub-clause (c).

#### **9.5 Default**

If the Contractor fails to comply with the instruction under Clause 9.4 or any other instructions or orders from the Supervisor and/or the Technical Representative, or fails to execute the Works or any part, with the diligence that will ensure its completion within the Period of Performance set forth in Clause 3.2 of this Contract, including any extension thereof, the AADF shall be entitled employ and pay other persons to carry out the Works and may, at its own discretion, by written notice to Contractor, terminate the right to proceed with the Works (or the separable part of the Works) that has been delayed or which is not in accordance with the Contract. In this event, AADF may take possession of and use any materials, appliances, and plant on the Site necessary for completing the Works. Contractor and its sureties shall be liable to pay to the AADF all costs incurred by AADF in completing the Works and any damages arising from this failure, whether or not Contractor's right to proceed with the Works is terminated.

#### **9.6 Acceptance of the Works**

9.6.1 The Contractor shall notify in writing the completion of the Works to the Supervisor and, within 30 days, submit to the Supervisor the complete technical legal documentation as per the applicable legislation in force.

#### **9.4 Punimet Korrigjuese**

Pavarësisht testimëve ose certifikimëve të mëparshme, Mbikëqyrësi mund të udhëzojë Kontraktorin që:

- (a) të heqë nga Kantieri dhe të zëvendësojë të gjithë Pajisjet apo Materialet që nuk janë në përputhje me Kontratën,
- (b) të heqë dhe ribëjë çdo punim tjetër që nuk është në përputhje me Kontratën, dhe
- (c) të kryejë çdo punë që kërkohet urgjentisht për sigurinë e Punimeve, për shkak të një aksidenti, një ngjarjeje të paparashikueshme ose një situatë tjetër.

Kontraktori do të përmbushë udhëzimin brenda një kohe të arsyeshme, e cila do të jetë koha (nëse ka) e specifikuar në udhëzim, ose menjëherë nëse është specifikuar situatë urgjente sipas pikës (c).

#### **9.5 Mospërmbushje e detyrimeve**

Nëse Kontraktori nuk përmbush udhëzimet sipas Nenit 9.4 ose çdo udhëzimi apo udhër tjetër të dhënë nga Mbikëqyrësi dhe/ose Përfaqësuesi Teknik apo nuk zbaton Punimet ose pjesë të tyre, me përgjegjësinë e duhur që do të garantojë përfundimin e Punimeve brenda Periudhës së Përmbushjes të përcaktuar në Nenin 3.2 të kësaj Kontrate, duke përfshirë çdo zgjatje të saj, AADF do të ketë të drejtën të kontraktojë dhe të paguajë persona të tjerë për të kryer Punimet dhe mund, sipas diskrecionit të vet, me njoftim me shkrim drejtuar Kontraktorit, t'i heqë të drejtën Kontraktorit për vazhdimin e Punimeve (ose pjesëve të veçanta të Punimeve) që janë kryer me vonesë ose që nuk janë në përputhje me Kontratën. Në këtë rast, AADF mund të marrë në zotërim dhe të përdorë çdo material, aparatura dhe pajisje në Kantier, që janë të nevojshëm për përfundimin e Punimeve. Kontraktori dhe garantuesit e tij do të jenë të detyruar t'i paguajnë AADF të gjitha shpenzimet e bëra nga AADF për përfundimin e Punimeve dhe çdo dëm të shkaktuar që rrjedh nga kjo mospërmbushje, pavarësisht nëse Kontraktorit i është hequr apo jo e drejta për të vazhduar punimet.

#### **9.6 Pranimi i Punimeve**

9.6.1 Kontraktori duhet të njoftojë me shkrim Mbikëqyrësin për përfundimin e Punimeve dhe, brenda 30 ditëve, t'i dorëzojë Mbikëqyrësit dokumentacionin e plotë tekniko-ligjor sipas legjislacionit të zbatueshëm në fuqi.

9.6.2 This Contract shall not be considered completed prior to the signing of a Final Acceptance Certificate which states that the Works are completed, finished and maintained in accordance with the provisions of this Contract.

9.6.3 Neither AADF review, provisional or final approval or acceptance of, nor payment for the Works required under this Contract shall be construed as a waiver of any rights under this Contract or in any way relieve the Contractor of its obligations regarding the quality of the finished Works and the Plant and Materials used therein, and Contractor shall be and will remain liable to AADF in accordance with applicable laws for all damages to AADF or the Beneficiary caused by Contractor's negligent performance of any of the Works furnished under this Contract.

## **10. RIGHTS AND OBLIGATIONS OF THE CONTRACTOR**

### **10.1 Joint and Several Liability**

If the Contractor constitutes (under applicable Laws) a joint venture, consortium or other unincorporated grouping of two or more persons:

- (a) these persons shall be deemed to be jointly and severally liable to the AADF for the performance of the Contract;
- (b) these persons shall notify the AADF of their leader who shall have authority to bind the Contractor and each of these persons; and
- (c) the Contractor shall not alter its composition or legal status without the prior consent of the AADF.

### **10.2 Subcontractors**

Contractor shall not subcontract any part of the Works under this Contract.

### **10.3 Standards of Work**

Contractor shall perform all Works under this Contract to a high standard and within the time limits prescribed as per this Contract, in compliance with any and all statutory regulations applicable in the Republic of Albania, labor safety and the fire regulations, as well as in conformity

9.6.2 Kjo Kontratë nuk do të konsiderohet e përfunduar përpara nënshkrimit të Certifikatës Përfundimtare të Marrjes në Dorëzim, në të cilën deklarohet se Punimet janë zbatuar, përfunduar dhe mirëmbajtur në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate.

9.6.3 As vlerësimi, miratimi ose pranimi i përkohshëm ose përfundimtar nga ana e AADF-së, as pagesa për Punimet e kërkuara sipas kësaj Kontrate nuk do të interpretohet si heqje dorë nga ndonjë e drejtë e specifikuar sipas kësaj Kontrate dhe nuk e çliron në asnjë mënyrë Kontraktorin nga detyrimet e tij në lidhje me cilësinë e Punimeve të përfunduara dhe Pajisjeve dhe Materialeve të përdorura në to. Kontraktori do të mbetet përgjegjës ndaj AADF, në përputhje me ligjet në fuqi, për të gjitha dëmet ndaj AADF ose Përfituesit, të shkaktuara nga puna neglizhuese e Kontraktorit në zbatimin e të gjitha Punimeve të parashikuara në këtë Kontratë.

## **10. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E KONTRAKTORIT**

### **10.1 Përgjegjësia Solidare**

Nëse Kontraktori është (sipas ligjeve në fuqi) një sipërmarrje e përbashkët, konsorcium ose grupim tjetër i pathemeluar prej dy ose më shumë personash:

- (a) këta persona do të konsiderohen se janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës ndaj AADF për përmbushjen e Kontratës;
- (b) këta persona do të njoftojnë AADF për drejtuesin e tyre, i cili do të ketë tagrat e përfaqësimit për të detyruar Kontraktorin dhe secilin prej këtyre personave; dhe
- (c) Kontraktori nuk do të ndryshojë përbërjen ose statusin e tij ligjor pa pëlqimin paraprak të AADF.

### **10.2 Nën- kontraktorët**

Kontraktori i ndalohet të nënkontrakttojë palë të treta për realizimin e Punimeve të specifikuar në këtë Kontratë.

### **10.3 Standardet e Punimeve**

Kontraktori do të realizojë të gjitha Punimet sipas kësaj Kontrate me standard të lartë dhe brenda afateve të përcaktuara në këtë Kontratë, në përputhje me gjitha rregulloret e detyrueshme të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë, me rregulloret e sigurisë në punë dhe mbrojtjes kundër

with the requirements and instructions of AADF, where these do not contravene any of the above. All Works carried out by Contractor shall comply with the following codes and regulations, as applicable: EN standards, Euro codes and Albanian Laws and standards.

#### 10.4 Permits and Responsibilities

Contractor shall, without additional expense to AADF, be responsible for obtaining any necessary licenses, permits and authorizations and for complying with all laws, codes and regulations applicable to the performance of the Works. Contractor shall also be responsible for:

- coordination with the Beneficiary or any other third party involved in the Project for obtaining access to the Site and in relation to any other issues affecting the performance of the Works as per the terms of this Contract;
- all damages to persons or property that occurs as a result of Contractor's fault or negligence;
- all materials delivered and work performed until completion and acceptance of the entire Works.

#### 10.5 Layout of Work

Contractor shall lay out its work based on the baselines and benchmarks indicated on the Detailed Design, and shall be responsible for all measurements in connection with the layout. Contractor shall furnish, at its own expense, all stakes, templates, platforms, equipment, tools, materials, and labor required to lay out any part of the Works. Contractor shall be responsible for executing the Works to the lines and grades that may be established or indicated by the Technical Representative and Supervisor. Contractor shall also be responsible for maintaining and preserving all stakes and other marks established by the Supervisor until authorized to remove them. If such marks are destroyed by Contractor or through its negligence before their removal is authorized by the Supervisor, Contractor will replace them and deduct the expense of the replacement from any amounts due or to become due to Contractor. In relation to the signs and boards needed as part of the Site set-up, Contractor shall use the templates approved by Supervisor and AADF for this purpose.

zjarrit, si dhe me kërkesat dhe udhëzimet e AADF, kur këto nuk bien ndesh me asnjë nga standardet e sipërpërmendura. Të gjitha punimet e kryera nga Kontraktori do të jenë në përputhje me kodet dhe rregulloret, siç janë të zbatueshme: standardet EN, kodet Euro, si dhe ligjet dhe standardet e Republikës së Shqipërisë.

#### 10.4 Lejet dhe përgjegjësitë

Kontraktori do të mbajë përgjegjësi, pa shpenzime shtesë për AADF, për marrjen e çdo licence, lejeje dhe autorizimi të nevojshëm, si dhe për respektimin e të gjitha ligjeve, kodeve dhe rregulloreve të zbatueshme për kryerjen e Punimeve. Kontraktori do të mbajë gjithashtu përgjegjësi për:

- koordinimin me Përfituesin ose çdo palë tjetër të tretë të përfshirë në Projekt në lidhje me marrjen e aksesit në Kantier dhe në lidhje me çdo çështje tjetër që ndikon në përmbushjen e Punimeve sipas kushteve dhe afateve të kësaj Kontrate;
- të gjitha dëmet ndaj personave ose pronës që ndodhin si rezultat i fajit ose neglizhencës së Kontraktorit;
- të gjitha materialet e dorëzuara dhe punën e kryer deri në përfundimin dhe pranimin e të gjithë Punimeve.

#### 10.5 Planvendosja e punimeve

Kontraktori do të bëjë planin e vendosjes së Punimeve, duke u bazuar në referencat dhe specifikimet e treguara në Projektin e Detajuar, dhe do të jetë përgjegjës për të gjitha matjet në lidhje me planin e vendosjes. Kontraktori do të sigurojë, me shpenzimet e veta, të gjitha piketat, formatet, platformat, pajisjet, mjetet, materialet dhe ekspertizën e nevojshme për të realizuar planin e vendosjes së çdo pjese të Punimeve. Kontraktori do të jetë përgjegjës për realizimin e Punimeve sipas linjave dhe shkallëve që mund të përcaktohen ose udhëzohen nga Përfaqësuesi Teknik dhe Mbikëqyrësi. Kontraktori do të jetë gjithashtu përgjegjës për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e të gjitha piketave dhe markimeve të tjera të vendosura nga Mbikëqyrësi derisa të autorizohet për heqjen e tyre. Nëse këto markime prishen apo dëmtohen nga Kontraktori ose nga neglizhenca e tij përpara se heqja e tyre të autorizohet nga Mbikëqyrësi, Kontraktori do t'i zëvendësojë ato dhe do të zbrësë shpenzimet për çdo zëvendësim të tillë nga çdo shumë që i detyrohet ose do t'i detyrohet Kontraktorit. Në lidhje me markimet dhe tabelat e nevojshme si pjesë e planimetrisë të Kantierit, Kontraktori do të përdorë formate të miratuara nga Mbikëqyrësi dhe AADF për këtë qëllim.

## 10.6 Specifications and Drawings for Construction

10.6.1 Upon signature of this Contract, Contractor shall review the constructability of the Detailed Design documents provided by the Employer, and notify the Supervisor on its findings in writing within 30 (thirty) days from the signature of the Contract. The latter shall notify the Employer. Contractor undertakes and warrants that, in relation to any error, fault or other aspects of the technical specification found in the Detailed Design, it has the experience necessary to provide his technical solution accompanied by the related costs and to notify the Supervisor within the term specified in this Clause on such costs, as well as time affecting the Period of Performance. Contractor is liable for any loss or damage of the Works, Plants and Materials due to errors or fault in the Detailed Design or other aspects of the technical specifications, unless the Contractor has notified in due time the Employer and Supervisor on such issues, as stipulated under this Clause.

10.6.2 Contractor shall keep a copy of the drawings and specifications on the Site and shall give to the Technical Representative and/or Supervisor. Anything mentioned in the specifications and not shown on the drawings or BoQ, or shown on the drawings or BoQ and not mentioned in the specifications shall be of like effect as if shown or mentioned in all of them. In case of a discrepancy in the figures, drawings, BoQ or specifications, the matter shall be promptly submitted to the Supervisor, who shall promptly make a determination in writing, getting approval by the Technical Representative. Any adjustment by Contractor without such a determination shall be at its own risk and expense. Supervisor shall furnish, from time to time, clarifications of detailed drawings and other information as considered necessary. For the avoidance of any doubt, the Contractor is fully liable for the designs prepared by the Contractor during the execution of the Works and the Contractor should always take care to consider the implications of

## 10.6 Specifikimet teknike dhe vizatimet

10.6.1 Pas nënshkimit të kësaj Kontrate, Kontraktori do të shqyrtojë lehtësinë e zbatimit të Projektit të Detajuar të ofruar nga Punëdhënësi dhe do të njoftojë Mbikëqyrësin për gjetjet e tij me shkrim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga nënshkrimi i Kontratës. Ky i fundit do të njoftojë Punëdhënësin. Kontraktori merr përsipër dhe garanton që, për çdo gabim, defekt ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike të evidentuara në Projektin e Detajuar, ka përvojën e nevojshme për të ofruar zgjidhje teknike që shoqërohen me kostot përkatëse. Kontraktori do të njoftojë Mbikëqyrësin brenda afatit të përcaktuar në këtë Nen për kosto të tilla, si edhe për kohën që ndikon në Periudhën e Përmbushjes së Kontratës. Kontraktori është përgjegjës për çdo humbje ose dëmtim të Punimeve, Pajisjeve dhe Materialeve për shkak të gabimeve në Projektin e Detajuar ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, përveçse në rastet kur Kontraktori ka njoftuar në kohën e duhur Punëdhënësin dhe Mbikëqyrësin për çështje të tilla, siç përcaktohet në këtë Nen.

10.6.2 Kontraktori do të mbajë kopje të vizatimeve dhe specifikimeve teknike në Kantier, të cilat do t'ua japë Përfaqësuesit Teknik dhe/ose Mbikëqyrësit. Çdo aspekt që përmendet në specifikime dhe që nuk paraqitet në vizatime ose preventiv, ose paraqitet në vizatime ose preventiv dhe nuk përmendet në specifikime, do të ketë të njëjtin efekt sikur të paraqitet ose të përmendet në të gjitha. Në rast mospërputhjeje në shifra, vizatime, preventiv ose specifikime, problemi do t'i paraqitet menjëherë Mbikëqyrësit, i cili do të marrë menjëherë një vendim me shkrim dhe do të kërkojë miratimin nga Përfaqësuesi Teknik. Kontraktori, në rast se bën një rregullim apo ndërhyrje pa një vendim të tillë, do të mbajë përgjegjësi për çdo humbje, dëmtim, kosto dhe detyrim të mundshëm që lidhen me këtë mospërputhje. Mbikëqyrësi do të japë, herë pas here, sqarime për vizatimet e detajuara dhe informacione të tjera, sipas nevojës. Për shmangien e çdo dyshimi, Kontraktori mban përgjegjësi të plotë për projektimet e përgatitura nga Kontraktori gjatë zbatimit të Punimeve dhe duhet të marrë vazhdimisht në konsideratë implikimet e projektit, edhe

the design, even if he thinks he has no design responsibility whatsoever.

## **10.7 Safety Procedures and Accidents Prevention**

10.7.1 Contractor, in accordance with the safety plan submitted as part of the tender package and approved in writing by the Technical Representative and Supervisor before commencement of Works, shall provide and maintain work environments and procedures that will (1) safeguard the public, as well as Contractor's personnel, property, materials, supplies, and equipment exposed to Contractor's operations and activities; (2) avoid interruptions in institutions operations whenever possible, and avoid delays in project completion dates; and, (3) control costs in the performance of this Contract.

10.7.2 Contractor shall provide appropriate safety barricades, signs, and signal lights; and comply with all safety standards, laws, regulations, codes, as required under this Contract (DMC no.312 dated on 5.5.2010) and the legislation in force in Albania. Compliance with such rules and regulations is the sole responsibility of the Contractor.

## **10.8 Quality Assurance**

10.8.1 The Contractor shall institute a quality assurance system to demonstrate compliance with the requirements of the Contract. The system shall be in accordance with the details stated in the Contract. The Supervisor shall be entitled to audit any aspect of the system.

10.8.2 Details of all procedures and compliance documents shall be submitted to the Supervisor for information before each design and execution stage is commenced. When any document of a technical nature is issued to the Supervisor, evidence of the prior approval by the Contractor himself shall be apparent on the document itself.

10.8.3 Compliance with the quality assurance

sikur të mendojë se nuk ka asnjë përgjegjësi për projektin.

## **10.7 Procedurat e Sigurisë dhe Parandalimi i Aksidenteve**

10.7.1 Kontraktori, në përputhje me planin e sigurisë të dorëzuar si pjesë e paketës së tenderit dhe të miratuar me shkrim nga Përfaqësuesi Teknik dhe Mbikëqyrësi para fillimit të Punimeve, do të sigurojë dhe mirëmbajë mjediset dhe procedurat e punës që (1) do të mbrojnë publikun, si dhe personelin e Kontraktorit, pronën, materialet, furnizimet dhe pajisjet gjatë operacioneve dhe aktiviteteve të Kontraktorit; (2) do të shmangin ndërprerjet gjatë funksionimit të institucioneve kurdoherë që është e mundur dhe do të shmangin vonesat gjatë realizimit të projektit sipas afateve; dhe (3) do të mbajnë në kontroll kostot gjatë zbatimit të kësaj Kontrate.

10.7.2 Kontraktori duhet të sigurojë masa të përshtatshme sigurie si pengesat, shenjat dhe dritat sinjalizuese, dhe do të zhvillojë veprimtarinë e tij në përputhje me të gjitha standardet, ligjet, rregulloret, kodet e sigurisë, siç kërkohet sipas kësaj Kontrate (VKM nr. 312, datë 5.5.2010) dhe legjislacionit në fuqi në Shqipëri. Pajtueshmëria me këto rregulla dhe rregullore është përgjegjësi vetëm e Kontraktorit.

## **10.8 Garantimi i Cilësisë**

10.8.1 Kontraktori, për të demonstruar pajtueshmërinë me kërkesat e Kontratës, do të krijojë një sistem të sigurimit të cilësisë. Ky sistem do të jetë në përputhje me detajet e përcaktuara në Kontratë. Mbikëqyrësi do të ketë të drejtën të auditojë çdo aspekt të këtij sistemi.

10.8.2 Detajet e të gjitha procedurave dhe dokumenteve të pajtueshmërisë do t'i dorëzohen Mbikëqyrësit. Ky i fundit do të vihet në dijeni për të gjitha këto detaje, përpara se të fillojë çdo fazë projektimi dhe zbatimi. Kur një dokument me natyrë teknike i jepet Mbikëqyrësit, dëshmia e miratimit paraprak nga vetë Kontraktori duhet të jetë e dukshme në vetë dokumentin.

10.8.3 Pajtueshmëria me sistemin e sigurimit të

system shall not relieve the Contractor of any of his duties, obligations or responsibilities under the Contract.

### **10.9 Operations and Storage**

10.9.1 Temporary buildings (e.g., storage sheds, shops, offices) and utilities may be erected by Contractor only with the approval of the Technical Representative and shall be built with labor and materials furnished by Contractor without expense to AADF. The temporary buildings and utilities shall remain the property of Contractor and shall be removed by Contractor at its own expense upon completion of the Works.

10.9.2 Contractor shall use only established roadways and bridges, or use temporary roadways. When materials are transported in executing the Works, vehicles shall not be loaded beyond the loading capacity recommended by the manufacturer of the vehicle or beyond the capacity of the infrastructure being used. When it is necessary to cross curbs or sidewalks, Contractor shall protect the property from damage. Contractor shall repair or pay for the repair of any damaged curbs, sidewalks, bridges, and roads.

### **10.10 Availability and Use of Utility Services**

Contractor, at its expense and in a workmanlike manner and to the satisfaction of the Technical Representative and Supervisor, shall install and maintain all necessary temporary connections and distribution lines, and all meters required to measure the amount of electricity and water of each utility used for the purpose of determining charges. Before final acceptance of the Works by AADF, Contractor shall remove all the temporary connections, distribution lines, meters, and associated equipment. It is Contractor's responsibility to obtain all special permits and satisfy all legal and regulatory requirements in relation to these connections and to perform payment of any charges related to the use of utility services.

### **10.11 Differing Site Conditions**

10.11.1 Contractor shall promptly give a written notice to the Technical Representative

cilësisë nuk do ta çlirojë Kontraktorin nga asnjë nga detyrat, detyrimet ose përgjegjësitë e tij sipas Kontratës.

### **10.9 Operacionet dhe Magazinimi**

10.9.1 Ndërtesat e përkohshme (p.sh. magazinat, punishtet, zyrat) ose objektet e shërbimit mund të ndërtohen nga Kontraktori vetëm me miratimin e Përfaqësuesit Teknik dhe do të ndërtohen me fuqinë punëtore dhe materialet e Kontraktorit, pa shpenzime për AADF. Këto struktura të përkohshme do të mbeten pronë e Kontraktorit dhe do të hiqen nga Kontraktori me shpenzimet e tij pas përfundimit të Punimeve.

10.9.2 Kontraktori do të përdorë vetëm rrugë dhe ura ekzistuese ose do të përdorë kalime të përkohshme. Kur transportohen materiale për zbatimin e Punimeve, automjetet nuk do të ngarkohen përtej kapacitetit të rekomanduar nga prodhuesi i tyre ose përtej kapacitetit të infrastrukturës që përdoret. Në rast të kalimeve mbi trotuare, Kontraktori do të mbrojë pronën nga dëmtimi. Kontraktori duhet të riparojë çdo pjesë trotuari, ure apo rruge të dëmtuar ose të bëjë zhdëmtimin e tyre.

### **10.10 Disponueshmëria dhe Përdorimi i Shërbimeve Utilitare**

